

---

Fier, më 19/04/2021

**KALLËZIM PENAL**

**KALLZUES:** PARTIA DEMOKRATIKE DEGA LUSHNJE

**ME OBJEKT:** Kallëzim i veprës penale "Shpërdorim i detyrës",  
parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, *Neni 328*  
"Dhenia e shperblimeve dhe e premtimeve".

**KUNDER:**

**DREJTUAR:** PROKURORISË PRANE GJYKATES SE SHKALLES SË PARE  
LUSHNJE

---

*I nderuar Z. Prokuror,*

Bazuar në nenet 280, 283 të K.Pr.Penale, si dhe nenit 328 dhe 248 të Kodit Penal, parashtrajmë këtë kallëzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

**I. LIGJI I APLIKUESHËM**

**1.1.** Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 dhe dispozitat tranzitore e tij parashikon se:

*Neni 280*

***Marrja dijëni për veprën penale***

*Prokurori dhe policia marrin dijëni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.*

*Neni 283*

***Kallëzimi nga ana e shtetasve***

*Çdo person që ka marrë dijëni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*